



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësor Privat  
Zyra Përmbaimore Private "Ardael" shpk

Nr.1433 Regj.

Tirane, me.19.04.2022

V E N D I M  
"PËR SHPALLJEN PER SHITJEN ME ANKAND  
TE SENDEVE TË PALUAJTSHME"

Unë Ardian Elezi, Përmbaues Gjyqësor Privat, përfaqesues i Zyrës Përmbaimore "Ardael" shpk, pasi u njoha me materialet e dosjes përmbaimore me palë kreditore **Banka Credins sh.a**, me palë debitore **Vladimir Rexhep Dervishi** dhe dorezanese **Leme Adem Dervishi** me objekt: kthim kredie bankare.

**KONSTATOVA:**

Në regjistrin e titujve ekzekutivë të Zyrës Përmbaimore "Ardael", me Përmbaues Gjyqësor Privat Ardian Elezi, është regjistruar kërkesa për ekzekutimin e të titullit ekzekutiv, Kontratë Kredie Nr.373 date 29.01.2009, për të cilin është lëshuar Urdheri i Ekzekutimit Nr.1014 Akti dt.20.02.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tirane.

Mbasi ka kaluar afati i ekzekutimit vullnetar ekzekutimi i titullit ka kaluar në ekzekutim në mënyrë të detyrueshme duke u sekuestruar sendi i lenë në hipoteke. Pasuria e sekuestruar është si me poshte:

*1.Pasuria me nr.43/12,ZK.1840,Vol.2,Fq.11,lloji "Are" me sipërfaqe 4600 m2, me adrese në fshatin Gramez, Kruje në pronësi të Vladimir Rexhep Dervishi. Kufizimet e pasurisë:V.-308,L.-317,J.-43/11,P.-316.*

Nga ana ime si përmbaues gjyqësor janë njoftuar palët dhe u është kërkuar arritja e marrëveshjes për caktimin e vlerës së sendit duke u lënë në dispozicion afatin ligjor prej 7 ditësh. Duke parë që marrëveshje nuk është arritur dhe pranë meje si përmbaues gjyqësor palët nuk kanë depozituar asnjë marrëveshje për të përcaktuar çmimin e sendit të sekuestruar është caktuar ekspert i licencuar. Mbasi është paraqitur akti i ekspertimit nga ana ime është caktuar çmimi i sendit duke iu komunikuar palëve vlerën e pasurive të sekuestruara si dhe duke i njoftuar që në rast mos shlyerje shlyerje, pasuria do të nxirret në shitje. Nga ana e palës debitorë nuk është shlyer detyrimi dhe për rrjedhojë për pasurinë e paluajtshme është shpallur ankand i parë dhe ankand i dytë. Në ankandin e parë dhe të dytë nuk u paraqit asnjë ofertes në këto kushte duhet të shpallet ankand i tretë për shitjen e pasurisë së paluajtshme për pasurinë e cila do të nxirret në shitje duke i zbritur 10 përqind të çmimit të përcaktuar në ankandin e dytë.

**Për këto arsye:**  
Në bazë të nenet 577,568 e vijues të K.Pr.C.

**V E N D O S A :**

Shpalljen për shitjen në ankand të tretë për pasurinë e paluajtshme në pronësi të debitorit **Vladimir Rexhep Dervishi**. Pasuria që shpallet në shitje me ankand është si më poshtë:

- Pasuria me nr.43/12,ZK.1840,Vol.2,Fq.11,lloji "Are" me sipërfaqe 4600 m<sup>2</sup>, me adresë në fshatin Gramez,Krujë, në pronësi të **Vladimir Rexhep Dervishi**. Kufizimet e pasurisë:V.-308,L.-317,J.-43/11,P.-316.

**Ankandi për pronën e mësipërme fillon me cmim fillestar në masën 1,108,800 (një milion e njeqind e tete mijë e teteqind ) leke.**

Secili ofertues që merr pjesë në ankand, përpara fillimit të ankandit duhet të depozitojë si garanci në llogarinë e Zyres Përbarimore "Ardael" shpk një shumë të hollash të barabartë me 10% të cmimit të sendit të caktuar në shpallje.

Ankandi do të zhvillohet në datën **19.05.2022 ora 16:00**, pranë zyrës së Zyres Përbarimore Private "Ardael" shpk të ndodhur në adresën Rr."Xhorxh W Bush", Përballe Parlamentit,Tiranë.

Ky vendim i komunikohet kreditorit, debitorit në adresën e tyre, gjithashtu ky vendim afishohet në vendet e përcaktuara në nenin 568 të K.Pr.Civile.

Kundër vendimit të përbaruesit palët mund të bëjnë ankim të veçantë.

**ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE "ARDAEL" sh.p.k**  
**PERMBARUES GJYQESOR**  
**ARDIAN ELEZI**

